

VENDIM
Nr.249, datë 3.10.2011

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR “TV ABC NEWS”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat vendor “TV ABC News”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge.
 2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
- Ky vendim i shtrin efektet nga data 3.1.2011 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati